

**VENDIM**  
**Nr. 359, datë 24.4.2013**

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 424, DATË 2.6.2010 TË  
KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR MIRATIMIN E RREGULLORES PËR  
SISTEMIN E AKREDITIMIT, ORGANIZIMIN DHE VEPRIMTARINË E  
INSTITUCIONEVE TË SIGURIMIT TË JASHTËM TË CILËSISË", TË  
NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 60 të ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pika 10 e nenit 6 "Organizimi dhe funksionimi i Këshillit të Akreditimit", të rregullores "Për sistemin e akreditimit, organizimin dhe veprimtarinë e institucioneve të sigurimit të jashtëm të cilësisë", miratuar me vendimin nr. 424, datë 2.6.2010 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, ndryshohet, si më poshtë vijon:

"10. Mbledhja e Këshillit të Akreditimit zhvillohet kur marrin pjesë jo më pak se 7 (shtatë) anëtarë të tij. Ajo nuk zhvillohet nëse, së paku, një ekspert i huaj nuk është i pranishëm."

2. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Këshilli i Akreditimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
Sali Berisha